




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrisë
Opština Vucitrn – Municipality of Vushtrri



Drejtoria e Arsimit

10 Nr. 822/24

Datë: 19.08.2024

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 “Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës” dhe bazuar në Kushtet dhe kriteret për regjistrim të nxënësve në klasën e (10) në Gjimnaze dhe Institucionet e Arsimit dhe aftësimit Profesional të shpallura nga MASHT, nr. 1400/22 dt.22.06.2022:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË VUSHTRRI SHPALL

KONKURS PLOTËSUES

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË GJIMNAZ DHE NË SHKOLLAT TEKNIKE DHE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2024/25

Planifikimi për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë (X) për Gjimnazin në Vushtrri:

SHKOLLA	Drejtimi	Nr. i Paraleleve	Nr. Nxënësve në një paralele	Gjithsej për drejtim
Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri	Natyror	1	30	30
	Shoqëroro – Gjuhësor	1	25	25
Gjithsej:		2	55	55

**Planifikimi për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë (X) për shkolla Teknike dhe
Profesionale- Vushtrri**

Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr.i paral.	Nr.i vendeve të lira për nxënës
SHMT" Lutfi Musiqi"	Makineri, prodhim dhe ndertimtari	Zdrukhtari/dual	1	5
		Dirigjimi kompjuterik i makinave	1	11
		Trafik rrugor	1	9
	Elektroteknik, Teknologji e informacionit dhe komunikimit	Mekatronikë	1	12
		Teknik e elektronikës	1	20
		Instalues elektrik	1	11
	SHMT" Lutfi Musiqi" Vushtrri	Gjithsej:	6	68
SH.M.P " Bahri Haxha" Vushtrri	Agrokulturë, pylltari, peshkatari dhe veterinar	Agrobiznes	1	2
		Përpunues i ushqimit dhe profesione të ngjajshme	1	6
	Shërbime	Kuzhinjer	1	4
	SHMP" Bahri Haxha" Vushtrri	Gjithsej:	4	12

Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente: - Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron) - Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe - Certifikatën e lindjes.

Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2024/2025, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e nëntë (IX) jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Konkursin dhe kriteret e detajuara për secilin drejtim i gjeni të publikuara në shkollat përkatëse dhe në web faqen e Komunës së Vushtrrisë; <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/>

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

- Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2024/2025, bëhet më datë : **19, 20, dhe 21 gusht 2024** duke filluar nga ora 8:00-16:00.
- Shpallja e rezultateve më **22.08.2024**
- Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet me 23.08.2024 duke filluar nga ora 8:00-16:00.

AFATI I ANKESAVE

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejt, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës.

Vërejtje: Mos shfrytëzimi i ankesës në afatin zyrtar, në shkollën përkatëse, nënkupton humbje e të drejtës për ankesë në shkollën e dytë në Drejtorinë e Arsimit (DKA) apo në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). DKA dhe MASHT nuk shqyrton asnjë ankesë nëse ajo paraprakisht nuk është shqyrtuar nga komisioni përkatës i shkollës.

 Albanëz Tahiraj
Drejtör i DKA-së